



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 515, Datë 22.05.2018**

**“Detyrimi për t’u informuar nga bankat e nivelit të dytë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Vendimit Nr. 453, datë 07.03.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve për Bankën e Shqipërisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe Bankat e nivelit të dytë” të Komisionit të Konkurrencës.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.05.2018, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Kërkim të dhënash nga disa banka të nivelit të dytë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Komisionit të Konkurrencës.

**Baza Ligjore:** Neni 24, shkronja d, neni 33, neni 73, pika 1, germa a) e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 53 i Kodit të Procedurës Administrative.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna me Vendimin Nr. 453, datë 07.03.2017 “Për Dhënien e disa Rekomandimeve për Bankën e Shqipërisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe Bankat e nivelit të dytë” dhe dinamikat e Sektorit Bankar,

**VËREN SE :**

Komisioni i Konkurrencës, nëpërmjet Vendimit Nr. 453, datë 07.03.2017 “Për Dhënien e disa Rekomandimeve për Bankën e Shqipërisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe Bankat e nivelit të dytë” vendosi ti rekomandoje bankave të nivelit të dytë:

- T’i mundësojnë klientit përzgjedhjen e vlerësuesit dhe të noterit në një listë të përzgjedhur të bankës, me qëllim rritjen e konkurrencës mes ofruesve të këtyre shërbimeve.
- Nxitja e kartave lokale, që nuk kanë kosto të larta si kartat që emetohen nga skemat ndërkombëtare (MasterCard, apo Visa etj..) që do të mundësonin më shumë përdorim dhe pranim të pagesave pasi kostot do të ishin më të ulta për bankat rrjedhimisht edhe për klientët.

- Të krijojnë lehtësira për lëvizshmërinë e klientëve duke ulur kostot "bllokuese" (kostot të cilat e detyrojnë klientin të qëndrojë pranë një banke si komisione për mbyllje llogarie, kosto administrative për klientin si kohë, rimbushje formularësh, përgatitje dokumentacioni, përdorimi i teknologjive të reja për tu afruar më shumë lehtësi tek klientët) si dhe të rrisin transparencën duke i bërë më të kuptueshme këto kosto për klientin, përfshirë edhe skedën e amortizimit të kredisë, e cila duhet të jetë në gjuhën shqipe në të gjitha bankat dhe për të gjitha rastet.

Sekretariati i Konkurrencës në zbatim të Vendimit, nëpërmjet shkresave nr. 236 datë 06.06.2017 dhe nr. 56, datë 24.01.2018 "Kërkesë për informacion", kërkoi nga 16 bankat e Sistemit Bankar informacion në lidhje me zbatueshmërinë e këtyre rekomandimeve.

Nga informacioni i depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës, konstatohet se Banka Credins; Banka ProCredit; Tirana Bank; Banka e Kreditit e Shqipërisë, Banka Veneto dhe Banka Kombëtare Greke nuk i janë përgjigjur kërkesës për informacion. Banka Kombëtare Tregtare, Banka Societe General, Banka Raiffeisen kanë sjellë informacion të paplotë.

Mungesa e informacionit po pengon monitorim të plotë të sjelljes së bankave në lidhje me zbatueshmërinë e rekomandime të Komisionit të Konkurrencës për shërbimin e noterëve dhe vlerësueseve të pasurisë.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, germa d, nenit 33 pika 2, nenit 73, pika 1, germa a) e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", (i ndryshuar),

#### **VENDOSI:**

1. T'i kërkojë Bankës Credins; Bankës Procredit; Tirana Bank; Bankës së Kreditit të Shqipërisë, Bankës Kombëtare Greke, Bankës Veneto, Bankës Societe General, Bankës Kombëtare Tregtare dhe Bankës Raiffeisen, që brenda datës 31.05.2018 të vërë në dispozicion të Komisionit të Konkurrencës të dhënat mbi:
  - a. listën e ofruesve të shërbimeve noterë dhe vlerësues të pasurive dhe numrin e procedurave të realizuara nga secili prej tyre gjatë vitit 2017.
  - b. Procedurën e përzgjedhjes së ofruesve të këtyre shërbimeve në vitin 2017.
2. Në rast të mos zbatimit të pikës 1 të dispozitivit të këtij vendimi, Komisioni në zbatim të nenit 73, pika 1, germa a) të ligjit nr. 9121 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (të ndryshuar), do të vendosë gjobë deri në 1 % të xhiros totale të vitit paraardhës financiar për shkelje të lehtë të konkurrencës;
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.